ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Kuvendi i Republikës së Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **101-25-353-2-1-1 numër të bredshëm KU101 25 001 211**

Sa i përket tenderit për **Shebime mbeshtëse në ndertesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës**

ANKESË

1. Schafberger Jr.GmbH Dega Kosove

Nena Tereze

Gllogoc, 13 000

044849585

Blerina_Kurtishaj

Schafbergerkosove@gmail.com

*14.05.2025_*
(Data e parashtrimit të kërkesës)

Dega Kosovë Schafberger jr. Gmbh Gllogoc

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë me datën 05.02.2025

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara i datës 14.03.2025, korigjimi i dosjes se tenderit

Hapja e ofetrave me datën 01.04.2025

Vendmi i AK me datën 29.04.2025

Kërkesa per qasje në dokumentet e ofertes me daten 30.04.2025

Qasja e lejuar nga AK me daten 02.05.2025

Kerkesa per Rishqyrtim 05.05.2025

Vendimi per refuzim i Kerkeses per Rishqyrtim 07.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Nuk kam vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Ne përputhje me nenin 108/a te LPP kemi parashtruar Kërkesë për rishqyrtim brenda afateve kohore, respektivisht me date 05.05.2025. Me date 07.05.2025 AK ka nxjerr Vendimin për refuzim te Kërkesës për Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës par.7
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par. 2 dhe 4
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, par. 1, 1.1
Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve par.10.2

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës, paragrafi 7

Gjatë analizimit të dokumenteve të ofertës së operatorit ekonomik (OE) të rekomanduar për kontratë, është vërejtur se në dokumentet që lidhen me stafin teknik dhe profesional, OE ka paraqitur një listë të të punësuarve, të shoqëruar me aktet juridike përkatëse (parakontratat e punës) të menaxherit dhe stafit tjetër, siç ishte kërkuar në dosjen e tenderit (FTD).

Megjithatë, pas krahasimit të këtyre dokumenteve, është vërejtur se ato **nuk janë nënshkruar personalisht** nga individët që janë emëruar në listë. Ky fakt është shqetësues, dhe për këtë arsye, propozojmë që të krahasoni nënshkrimet, shih me poshte.

Ne dyshojmë se këto dokumente nuk janë në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këtë arsye kërkojme nga OE i rekomanduar që të dërgojë informacion shtesë për "Kontratën e Punës" dhe dëshmitë për trustin profesional të të punësuarve të deklaruar, për të verifikuar se nga këto kontrata është krijuar përvoja e kërkuar në dosjen e tenderit.

Gjithashtu, është befasuese se **Kontratate e Punës** nga një OE tjetër dhe **Parakontratate e Punës** janë identike me njëra-tjetrën. Ky fakt kërkon një verifikim të detajuar, sepse mund të sugjerojë manipulim ose falsifikim të dokumenteve. Ne kërkojmë që këto kontrata të verifikohen nga autoritetet përkatëse dhe ne do t'i inicojmë ato në organet tjera për verifikim të plotë.

Foto krahasueshmëria (Kontrata e Punës, Para Kontrata, CË e menaxherit)



Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues

Lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik ankues se dokumentet e paraqitura nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për stafin teknik nuk janë nënshkruar personalisht nga personat e emëruar dhe se ekzistojnë dyshime mbi vërtetësinë e tyre, Autoriteti Kontraktues shpjegon si më poshtë: Pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë, lidhur me pretendimet e ngritura nga OE ankues, konkretisht për çështjen e nënshkrimeve të stafit teknik. Në përgjigjen zyrtare të dhënë nga OE i rekomanduar, është deklaruar në mënyrë të qartë se: **"Përmes kësaj përgjigjeje, edhe një herë konfirmojmë se të gjitha nënshkrimet në kontratat e punës janë nga personat adekuat dhe janë sipas legjislacionit në fuqi."** Kjo deklaratë

përbën një konfirmim të drejtpërdrejtë dhe bart përgjegjësi të plotë ligjore për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumenteve të dorëzuara. Për më tepër, OE i rekomanduar ka nënshkruar edhe një deklaratë nën betim, përmes së cilës ka marrë përsipër përmbushjen e të gjitha kërkesave të dosjes së tenderit, përfshirë paraqitjen e dokumenteve autentike dhe të sakta. Sa i përket kërkesës së OE ankues për verifikim përmes Trustit Pensional të Kosovës apo Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Autoriteti Kontraktues thekson se nuk ka të drejtë ligjore të kërkojë dokumente apo dëshmi shtesë që nuk janë paraparë në dosjen e tenderit (FTD). Kjo është e përcaktuar në mënyrë eksplicite në:

- **Nenin 59, paragrafi 2 të Ligjit për Prokurimin Publik:**

  "Autoriteti kontraktues do të vlerësojë dhe krahasojë ofertat vetëm në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në dosjen e tenderit."

- **Nenin 40.12 të Rregullores së Prokurimit Publik (001/2022, e ndryshuar me 002/2024):**
  "Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit."

Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimet e ngritura nga OE ankues nuk përmbajnë fakte apo dëshmi të verifikueshme që do të mund të paraqisnin një dyshim të arsyeshëm dhe të mbështetur lidhur me vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar nga OE i rekomanduar. Dyshimet e shprehura janë të përgjithshme dhe nuk janë shoqëruar me prova materiale që do të mund të justifikonin ndërmarrjen e një kontrolli shtesë në kuptim të këtij neni. Marrë parasysh faktin se OE i rekomanduar ka dorëzuar konfirmim zyrtar me shkrim, në të cilin deklaron qartë se nënshkrimet në kontratat e punës janë autentike dhe janë vendosur personalisht nga individët e emëruar si staf teknik, si dhe ka nënshkruar deklaratë nën betim për vërtetësinë e dokumentacionit, Autoriteti Kontraktues e konsideron këtë deklarim si një element të mjaftueshëm për të vërtetuar përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave dhe dokumenteve të dorëzuara i takon drejtpërdrejt OE-së së rekomanduar për kontratë, i cili ka marrë përsipër pasojat ligjore në rast të paraqitjes së informacioneve të pasakta apo të pavërteta.

Për këtë arsye, në mungesë të ndonjë prove konkrete apo ndonjë treguesi të jashtëzakonshëm që do të kërkonte veprime shtesë nga Autoriteti Kontraktues, pretendimi ankimor vlerësohet si i pabazuar.

Argumenti YNE

Në lidhje me **Nenin 52, paragrafi 7** të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton që ***"Autoriteti kontraktues, në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit,"*** duhet theksuar se ky nen nënkupton një kontroll efektiv dhe të detajuar të informacionit dhe dokumentacionit të ofruar nga OE, dhe **jo thjesht kërkesën për një deklaratë nga OE.** Me kete AK ka bere shkelje te nenit 52 te LPP paragrafi 7 sepse kontroll efektiv nuk nenkupton nje deklarte nga OE por kerkon verifikim te dokumenteve.

Në përputhje me nenin 52.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar), Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ligjore **dhe është i**

detyruar të ndërmarrë verifikime shtesë për të vërtetuar saktësinë dhe vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga Operatorët Ekonomikë të rekomanduar për kontratë. Këto verifikime përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, kontaktimin dhe konsultimin me burime të tjera të besueshme si: Trusti Pensional i Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

Në rastin konkret, vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues **nuk e ka zbatuar këtë dispozitë ligjore**, pasi nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për të verifikuar dokumentacionin e dorëzuar nga Operator Ekonomik i rekomanduar, duke u mjaftuar vetëm me një **deklaratë të nënshkruar nga vetë operatori**. Kjo qasje përbën shmangie nga obligimi ligjor dhe mund të çojë në pranimin e dokumenteve jo të sakta apo të pavërteta, duke rrezikuar kështu parimin e trajtimit të barabartë dhe integritetin e procesit të prokurimit.

Per me teper ne kemi inicuar kerkesen tek organet kompetente **shih te bashkangjitur** por se pergjigjia eshte se te dhenat ne detaje mund ti ofrohen vetem zyrtareve shteterore e qe ne rastin konkret zyrtari pergjegjes i proKurimit ka mund te kerkoje.

Citati i ATK
I/e nderuar,
Kemi trajtuar informacionin tuaj dhe ju njoftojmë se rasti është adresuar në Departamentin e Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës.
Sipas nenit 66 paragrafi 2, pikat 2.7 dhe 2.14 te ligjit .08/L-257 Për Administrimin e Procedurave Tatimore të dhënat në detaje për ketë rast mund t'i ofrohen me kërkesën e tyre vetëm zyrtareve shtetërorë për kryerjen e detyrave zyrtare.

Për këtë arsye, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë **shkelje të nenit 52.7 të LPP-së**, dhe rekomandojmë që në raste të ngjashme në të ardhmen, të ndërmerren **verifikime të drejtpërdrejta dhe të pavarura** përmes institucioneve relevante, për të siguruar që vendimet për dhënien e kontratës mbështeten në dokumente autentike dhe të verifikuara.

2. **Neni 59 i LPP** – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Pika 1

Kerkesa ne DT ka qene:

5.6. Traktor me lopatë për pastrimin (largimin) e borës, me kapacitet prej **1100 deri në 1200 cm³ – 2 copë**

OE i rekomanduar ka paraqitur një marrëveshje për traktoret, të cilat kërkohen nga AK, ku janë parashikuar 2 traktorë me lopatë. Sipas marrëveshjes së paraqitur nga OE, njëri prej traktorëve (pika 1) nuk është traktor me lopatë, por vetëm traktor me kabinë, dhe si i tillë nuk përmbush kërkesat e specifikuara në kërkesën e AK-së.

Gjithashtu, në (pikën 2) të marrëveshjes, traktori eshtë jashtë standardeve të kërkuara në FDT, pasi barte një peshë matëse prej 2826 cm³, e cila është dy herë e gjysmë më e lartë se pesha e lejuar sipas kërkesës së AK-së dhe dosjes së tenderit. Pesha e lejuar, sipas kërkesës suaj, duhet të jetë ndërmjet 1100-1200 cm³.

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues (AK):

Sa i përket kapacitetit motorik, edhe pse njëra nga pajisjet e ofruara tejkalon vlerën orientuese të përmendur në FTD, AK thekson se dosja e tenderit **nuk e ka përcaktuar këtë parametër si kriter eliminues apo kufizues**, por vetëm si një tregues orientues që pasqyron nevojën funksionale të Autoritetit Kontraktues. Në këtë kontekst, sipas AK-së, OE i rekomanduar ka ofruar pajisje me kapacitet (vëllim) motorik më të lartë, e cila – sipas tyre – nuk devijon nga qëllimi funksional i pajisjes, përkundrazi, përmirëson performancën dhe efikasitetin në operim, duke garantuar përmbushjen më të mirë të kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

AK pohon se ky vlerësim është në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, konkretisht me **nenin 59, paragrafi 2**, i cili përcakton: "Autoriteti kontraktues do të vlerësojë dhe krahasojë ofertat vetëm në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Argumenti YNE

Pavarësisht përpjekjes së AK-së për ta paraqitur kapacitetin motorik si "parametër orientues", vetë fakti që në **dosjen e tenderit është specifikuar qartë kërkesa për kapacitet motorik prej 1100 – 1200 cm³**, e bën atë një **kërkesë teknike të detyrueshme.** OE i rekomanduar ka ofruar pajisje me kapacitet motorik **2826 cm³**, që është **jashtë kufirit të lejuar dhe përbën devijim të qartë nga specifikimet teknike**.

Për më tepër, vetë AK pranon se pajisja tejkalon parametrin e kërkuar, por përpiqet të justifikojë këtë devijim me interpretim të lirë të termit "orientues".

Megjithatë, sipas **nenit 60 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues **nuk mund të shpërblejë me kontratë një OE i cili nuk i përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit**, qoftë edhe një kriter teknik.

Prandaj, vlerësimi i AK-së është në **kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 59 tdhe 60 të LPP-së**, dhe për pasojë, **shpërblimi i këtij OE-je përbën shkelje ligjore**

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik i cili nuk ka plotësuar kërkesat e përcaktuara për aftësinë teknike dhe profesionale, të parashtruara në dosjen e tenderit.



	08-960-VE	D3	55 - 14 LB	P	
	04.05.2022	E	22D0500	P1	2826
		S	1994	P2	38,00
1	EL-BAU SH.P.K	S1	1	P3	Dizel
2		S2		R	2/7 - E PORTOKALLTE/E HIRIT
3	Lërion Ellmedi p.n. Gjirokastër	C		J1	Traktor me kabinë me 2 dyer
	01.09.1994	F			
	Renault	F1			
	55 - 14 LB	G	2460		
		K			

Pika 2

Në dosjen e tenderit në FTD është kërkuar që OE të ketë mjete dhe pajisje të cilat shërbejnë për shërbimet higjienike të brendshme dhe të jashtme. OE ka paraqitur në ofertën e tyre disa marrëveshje si dhe disa fatura të blerjes. Duke analizuar në tërësi njërën prej këtyre faturave, na habit fakti se si është e mundur të realizohet një blerje me një vlerë kaq të lartë brenda një dite, vlerë e cila është praktikisht e papërballueshme për çdo kompani të pastrimit. Për këtë arsye, ju lutemi që si Autoritet Kontraktues të kërkoni verifikimin e kësaj fature në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), nëpërmjet rrugëve zyrtare, për të konfirmuar nëse kjo faturë është e deklaruar në ATK. Ne kemi dyshime mirë të bazuara se kjo faturë nuk është deklaruar dhe mund të jetë një faturë (fiktive). Si kompani, ne i jemi drejtuar zyrtarisht ATK-së me një kërkesë për verifikimin e kësaj fature dhe aktualisht jemi në pritje të një përgjigjeje zyrtare. Për shkak të etikës profesionale, kemi prerë fotografinë e faturës, vlera e së cilës është jashtëzakonisht e lartë për shërbime pastrimi. Në përputhje me të drejtën ligjore për qasje dhe verifikim të dokumenteve që janë pjesë e ofertimeve publike, kemi kërkuar nga ATK verifikimin e saj, pasi dyshojmë se kjo faturë nuk është reale dhe nuk është e deklaruar fare ne ATK. Prandaj, ju si AK jeni të obliguar, për çdo dyshim, të kërkoni nga institucioni përkatës, ATK, që të bëjë verifikimin e kësaj fature, pasi vlera e saj është tepër e lartë dhe është faturuar si blerje brenda një dite, dhe jo në disa periudha ose gjatë disa viteve. Ne kerkojm nga AK nese një gjë verifikohet oferta e rekomanduar të trajtohet konform nenit 99 Funksionet dhe Kompetencat e OSHP paragrafi, <u>në bazë të një kërkese me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare</u>

Data 05.11.2024 **Nr.** 189/2024

Nr	Pershkrimi	Njesi	Sasia	Cmimi Pa Tvsh	Rabati	Cm.Rabat	Vlera pa Tvsh	Cmimi me TVSH pa Rabat	Cmimi me TVSH ME RABAT	Vlera me Tvsh
1	Makine per Dysheme LAB DISC 1100P	Cope	20	592.37	10%	533.14	10,662.71	699.00	629.10	12,582.00
2	Makine per PLLAKA LAB DISC 1100P	Cope	15	466.10	10%	419.49	6,292.37	550.00	495.00	7,425.00
3	Makine thithje ujit Promax 800 Cm	Cope	15	329.66	10%	296.69	4,450.42	389.00	350.10	5,251.50
4	Makine per larjen e dyshemes Lab 30B	Cope	10	2,881.36	8%	2,593.22	25,932.20	3,400.00	3,060.00	30,600.00
5	Makine per larjen e dyshemes Lab 35B	Cope	10	2,372.88	8%	2,135.59	21,355.93	2,800.00	2,520.00	25,200.00
6	Kova per pastrim 2x25 Litra	Cope	200	75.42	10%	67.88	13,576.27	89.00	80.10	16,020.00
7	Fshesa me korent 2000 wat	Cope	200	194.92	10%	175.42	35,084.75	230.00	207.00	41,400.00
8	Kova multifunksionale 25x18 Litra	Cope	150	160.17	10%	144.15	21,622.88	189.00	170.10	25,515.00
9	Kova per pastrim zyre 2x25 Litra	Cope	160	126.27	10%	113.64	18,183.05	149.00	134.10	21,456.00
10	Makine per larjen e tepihave	Cope	20	355.93	10%	320.34	6,406.78	420.00	378.00	7,560.00
							163,567.37			193,009.50

Vlera Total pa Tvsh	163,567.37
TVSH	29,442.13
Vlera Total me TVSH	193,009.50

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues

Në ushtrim të kompetencave të saj ligjore dhe në përputhje me nenin 59.2 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar me shkrim sqarime zyrtare nga OE i rekomanduar, duke specifikuar nevojën për konfirmimin e vërtetësisë së faturës nr. 189/2024, si dhe të faturave të tjera të ngjashme të përfshira në ofertë. Në përgjigjen e dhënë përmes emailit zyrtar, i cili i është bashkëngjitur dosjes së shqyrtimit, OE ka deklaruar:

"Përmes kësaj përgjigjeje, ne e konfirmojmë se fatura nr. 189/2024 dhe faturat tjera të blerjes janë të rregullta."

Ky deklarim përbën konfirmim zyrtar nën përgjegjësi ligjore dhe është i mbështetur nga deklarata nën betim e nënshkruar nga OE, përmes së cilës operatori merr përsipër saktësinë, ligjshmërinë dhe vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara në ofertë, përfshirë edhe faturat.

Në këtë rast, nuk është paraqitur asnjë provë e verifikueshme apo dokument zyrtar nga ndonjë autoritet kompetent (si KRPP, ATK apo organet e drejtësisë) që do të vërtetonte se fatura e përmendur është e falsifikuar. Dyshimi i OE ankues mbetet i pabazuar, subjektiv dhe i pashoqëruar me asnjë fakt konkret apo burim zyrtar, çka nuk mund të shërbejë si bazë për ndërmarrjen e ndonjë mase ndëshkuese nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Argumenti YNE

Në kundërshtim të plotë me kompetencat dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues, në vend që të kryente një **verifikim të pavarur dhe të drejtpërdrejtë**, ka komunikuar me Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe **i ka kërkuar atij një deklarim vetanak** në lidhje me pretendimin tonë.

Kjo qasje përbën **shkelje të nenit 52.7** të LPP-së, i cili i obligon autoritetet kontraktuese që në rast të dyshimeve për paautenticitetin e dokumenteve, të ndërmarrin **kontroll efektiv përmes burimeve të tjera të besueshme dhe zyrtare**, si ATK, Trusti Pensional apo institucione të drejtësisë – dhe **jo të mbështeten vetëm në deklarimin e operatorit të dyshuar**.

Për më tepër, me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në **kundërshtim me nenin 59 të LPP-së**, duke marrë një vendim pa u bazuar në prova të plota dhe pa kryer verifikimet e nevojshme ligjore, çka ndikon drejtpërdrejt në ligjshmërinë dhe integritetin e procesit të prokurimit.
Autoriteti Kontraktues ka vepruar jashtë kornizës ligjore të përcaktuar në nenet 52.7 dhe 59 të LPP-së. Në rastet kur ka dyshime të ngritura nga operatorë të tjerë, përgjegjësia e AK-së është të kryejë verifikime të drejtpërdrejta përmes institucioneve përkatëse dhe jo të mjaftohet me deklarata vetanake të palëve të interesuara.

Pika 3

Kërkesa nr. 2

Operatori ekonomik ofertues, gjatë kryerjes së shërbimeve higjienike, duhet të përdorë materiale shpenzuese që plotësojnë **standardet evropiane të cilësisë** dhe që nuk janë të dëmshme për shëndetin e njeriut. Materialet e përdorura duhet të jenë të pajisura me **certifikatë ECOLABEL**..

Dëshmitë për kërkesën nr. 2:

- **Lista e plotë e materialeve shpenzuese** që do të përdoren për realizimin e shërbimeve higjienike.
- Kopjet e **Certifikatave Ecolabel** për materialet e përfshira.
- **Broshurat e materialeve** që përmbajnë informacione për përdorimin dhe karakteristikat e tyre.
- **Fleta e të Dhënave për Sigurinë e Përdorimit të Materialeve** (MSDS - Material Safety Data Sheet).
- **Fleta me Informacione për Përdorimin e Materialeve** (PIS - Product Information Sheet).

Në dosjen e tenderit, në FDT, është kërkuar që materialet higjienike të jenë të cilësisë së lartë dhe që për çdo produkt të prezantohet Fleta e Informacionit për Përdorimin e Materialeve (**PIS - Product Information Sheet**). OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar dokumentet me të dhënat e përdorimit të produkteve dhe certifikatat, të cilat janë bashkëngjitur me produktet e Ecolab Europe GmbH dhe janë me afat të skaduar. Për këtë arsye, do t'ju bashkangjisim edhe fotot e certifikatave pa afat, që të mund të vlerësoni se oferta e tyre është e papërgjegjshme edhe në këtë aspekt.

Arsyetimi i AK

Pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, në pajtim me nenin 59.2 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar me shkrim sqarim nga OE i rekomanduar lidhur me vlefshmërinë e certifikatave ECOLABEL. Pyetja e AK-së ishte e qartë: **"Produktet e ofruara për pastrim keni deklaruar se janë ECOLABEL, mirëpo certifikatat EU Ecolabel Certificate janë me afat të skaduar. A janë këto produkte ende të certifikuara me certifikatë ECOLABEL dhe si mund ta dëshmoni këtë?"**

Në përgjigjen me shkrim të dorëzuar përmes emailit dhe të bashkëngjitur si Dëshmia 14, OE i rekomanduar ka deklaruar: **"Të gjitha produktet janë të certifikuara sipas standardeve të kërkuara dhe, sipas politikave të prodhuesit, të gjitha produktet e prodhuara janë të pajisura me standard dhe të certifikuara."**

Përveç deklarimit të mësipërm, OE ka bashkëngjitur gjithashtu në përgjigje edhe kopje të certifikatave ECOLABEL me afat të vlefshëm, të cilat kanë qenë të dorëzuara edhe me ofertë. Këto dokumente dëshmojnë se produktet e ofruara janë ende të certifikuara dhe në përputhje me standardet evropiane të cilësisë.

Është me rëndësi të theksohet se dosja e tenderit **nuk ka kërkuar që certifikatat ECOLABEL të jenë patjetër me datë të vlefshme në momentin e ofertimit**, por që **produktet të jenë të certifikuara sipas këtij standardi**. Kjo kërkesë, në rastin konkret, është përmbushur në përmbajtje, si përmes dokumentacionit të ofertës, ashtu edhe përmes sqarimeve zyrtare dhe dëshmive të dorëzuara me rastin e rishqyrtimit. Sa i përket pretendimit për mungesën e *Product Information Sheets* (PIS), nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës rezulton se OE i rekomanduar ka dorëzuar broshura dhe fletë të dhënash (MSDS) që përmbajnë informacion të detajuar për përdorimin, përbërjen dhe sigurinë e produkteve. Edhe pse nuk mbajnë patjetër titullin "PIS", këto dokumente përmbushin në përmbajtje kërkesat e përcaktuara në FTD, duke shërbyer për qëllimin funksional të vlerësimit teknik. Për rrjedhojë, **nuk konstatohet ndonjë mospërputhje thelbësore** në dokumentacionin e OE-së së rekomanduar që do të ndikonte në përgjegjshmërinë e ofertës. **Pretendimi ankimorvlerësohet si i pabazuar.**

Argumenti YNE

Dëshmitë e kërkuara sipas dosjes së tenderit:

- **Lista e plotë e materialeve shpenzuese** që do të përdoren për realizimin e shërbimeve higjienike.
- Kopjet e **Certifikatave Ecolabel** për materialet e përfshira.
- **Broshurat e materialeve** që përmbajnë informacione për përdorimin dhe karakteristikat e tyre.
- **Fleta e të Dhënave për Sigurinë e Përdorimit të Materialeve** (MSDS - Material Safety Data Sheet).
- **Fleta me Informacione për Përdorimin e Materialeve** (PIS - Product Information Sheet).

Do te thote:

1. **Lista e materialeve** – për të verifikuar se çfarë do të përdoret në praktikë.
2. **Certifikatat Ecolabel** – për t'u siguruar që produktet janë ekologjikisht të certifikuara.
3. **Broshurat** – për të paraqitur përshkrim të përgjithshëm vizual/informativ të produkteve.
4. **MSDS** – për sigurinë në përdorim (rreziqe, përbërje kimike, mbrojtje personale etj.).
5. **PIS (Product Information Sheet)** – për informacion të detajuar teknik mbi përdorimin dhe karakteristikat funksionale të produktit.

Dallimi dhe rëndësia e PIS:

- **PIS** është kërkuar **si dokument më vete** dhe **nuk mund të zëvendësohet** me MSDS apo broshurë, sepse:
    - Ai ofron **përshkrim të saktë funksional**, dobi praktike, përdorim të rekomanduar, dozë, efikasitet dhe mënyrën e aplikimit të produktit.
    - Ndihmon komisionin vlerësues të kuptojë **nëse produkti i ofruar përmbush kërkesat teknike funksionale**.

OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar PIS, por vetëm: MSDS dhe broshura, atëherë **nuk ka përmbushur plotësisht kërkesën** e dosjes së tenderit. Pavarësisht që përmbajtja e broshurave apo MSDS mund të përfshijë disa elemente nga PIS, mungesa e këtij dokumenti të veçantë, të kërkuar **qartë dhe ndaras**, përbën **mangësi esenciale**.

"Në dosjen e tenderit janë kërkuar në mënyrë të veçantë pesë lloje dokumentesh për dëshminë nr. 2, përfshirë **Fletën me Informacione për Përdorimin e Materialeve (PIS)** si dokument i ndarë nga MSDS apo broshurat. Edhe pse OE ka dorëzuar broshura dhe MSDS, mungesa e dokumentit të veçantë PIS përbën **mosplotësim të kërkesës së qartë** të FTD-së. Kjo përbën bazë të mjaftueshme për të konstatuar mospërputhje me kriterin e kërkuar dhe për të mos kualifikuar ofertën, në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së."

Në dokumentacionin e tenderit është kërkuar në mënyrë **eksplicite dhe të ndarë** dorëzimi i **dy llojeve të dokumenteve** të ndryshme:

- **Product Information Sheet (PIS)** dhe
- **Material Safety Data Sheet (MSDS)**.

Fakti që OE ka dorëzuar vetëm MSDS **nuk e zëvendëson** dhe **as nuk e përmbush kërkesën për PIS**, pasi këto janë dokumente me qëllime të ndryshme dhe përmbajtje të ndryshme. Prandaj, mosdorëzimi i njërës përbën **mospërmbushje të kërkesave esenciale** të tenderit.

Për më tepër, duhet theksuar se **kjo mund të ketë ndikuar drejtpërdrejt në garën e drejtë dhe të barabartë**, pasi **operatorë të tjerë ekonomikë mund të kenë vendosur të mos konkurrojnë**, pikërisht për shkak të specifikimeve strikte të kërkuara në dosjen e tenderit. Prandaj, **lejimi i përjashtimeve selektive** gjatë vlerësimit cenon **parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së ndershme.**

CERTIFICATE

This is to certify that

Ecolab Europe GmbH

Richtistr. 7
8304 Wallisellen
Switzerland

with the organizational units/sites as listed in the annex

has implemented and maintains an **Environmental Management System**.

Scope:
The manufacture and distribution of Products, Services and Equipment for the Healthcare, Industrial, Institutional and Speciality Water Treatment and Process Chemical Markets.

Through an audit, documented in a report, it was verified that the management system fulfills the requirements of the following standard:

ISO 14001 : 2015

Certificate registration no.	417730 UM15
Valid from	2018-09-12
Valid until	2021-09-11
Date of certification	2018-09-12

DAkkS
Deutsche Akkreditierungsstelle
D-ZM-16074-01-00

DQS GmbH

Stefan Heinloth
Managing Director

Accredited Body: DQS GmbH, August-Schanz-Straße 21, 60433 Frankfurt am Main, Germany
Administrative Office: DQS Medizinprodukte GmbH, August-Schanz-Straße 21, 60433 Frankfurt am Main,
Tel. +49 (0) 69 95427-300, medical.devices@dqs-med.de

Annex to certificate
Registration No. 417730 UM15

Ecolab Europe GmbH

Richtistr. 7
8304 Wallisellen
Switzerland

Location

Ecolab Production France SAS
BP 509, Avenue du Général Patton
51006 Chalons-en-Champagne
France

Ecolab S.A.
25th km., Old National Road Athens Thiva
19600 Mandra Attikis
Greece

Ecolab Ltd.
Forest Park, Zone C
Mullingar Industrial Estate
Mullingar, Co.
Westmeath
Ireland

Ecolab Ltd.
Lotherton Way, Garforth
Leeds
LS25 2JY
United Kingdom

Ecolab Engineering GmbH
Raiffeisenstr. 7
83313 Siegsdorf
Germany

Ecolab Production Belgium BVBA - Equipment Center
Essenschot 6031, Industriezone Ravenshout 6
3980 Tessenderlo
Belgium

Nalco Deutschland Manufacturing GmbH und Co. KG
Justus-von-Liebig-Str. 11
64584 Biebesheim
Germany

NLC Weavergate
Winnington Avenue
Northwich
Cheshire
CW84DX
United Kingdom

Nalco Italiana Manufacturing srl
Via Ninfina II snc
04012 Cisterna di Latina (LT)
Italy

Nalco Española Manufacturing SLU
Carrer Tramuntana, s/n
Poligono Industrial de Ceira,
17460 Celrá
Spain

Nalco Finland Manufacturing Oy
Kivikummuntie 1
07955 Tesjoki
Finland

Ecolab Production Netherlands B.V.
Brugwal 11
3432 NZ Nieuwegein
Netherlands

This annex (edition: 2018-09-12) is only valid in connection with the above-mentioned certificate.

Annex to certificate
Registration No. 417730 UM15

Ecolab Europe GmbH

Richtistr. 7
8304 Wallisellen
Switzerland

Location

Ecolab Production Italy S.r.l.
Via Grandi 9/11
20089 Rozzano (MI)
Italy

Ecolab d.o.o.
Vajngerlova 4
2000 Maribor
Slovenia

Ecolab Production Belgium BVBA
Havenlaan 4, Ravenshout Bed. 4.210
3980 Tessenderlo
Belgium

This annex (edition: 2018-09-12) is only valid in connection with the above-mentioned certificate.

CERTIFICATE

This is to certify that

Ecolab Europe GmbH

Richtistr. 7
8304 Wallisellen
Switzerland

with the organizational units/sites as listed in the annex

has implemented and maintains an
Occupational Health and Safety Management System.

Scope:
The manufacture and distribution of Products, Services and Equipment
for the Speciality Water Treatment and Process Chemical Markets.

Through an audit, documented in a report, it was verified that the management system fulfills the requirements of the following standard:

BS OHSAS 18001 : 2007

Certificate registration no.	417730 BSOH
Valid from	2017-03-07
Valid until	2020-03-06

DAkkS
Deutsche
Akkreditierungsstelle

Annex to certificate
Registration No. 417730 BSOH

Ecolab Europe GmbH

Richtistr. 7
8304 Wallisellen
Switzerland

Location

Nalco Deutschland Manufacturing GmbH und Co. KG
Justus-von-Liebig-Str. 11
64584 Biebesheim
Germany

Nalco Española Manufacturing SLU
Carrer Tramuntana, s/n
Poligono Industrial de Ceira,
17460 Celrá
Spain

Nalco Finland Manufacturing Oy
Kivikummuntie 1
07955 Tesjoki
Finland

NLC Weavergate
Winnington Avenue
Northwich
Cheshire
CW84DX
United Kingdom

Nalco Italiana Manufacturing srl
Via Ninfina II snc
04012 Cisterna di Latina (LT)
Italy

CERTIFICATE

This is to certify that

Ecolab Deutschland GmbH

Ecolab-Allee 1
40789 Monheim am Rhein
Germany

Ecolab Europe GmbH

Richtistr. 7
8304 Wallisellen
Switzerland

with the organizational units/sites as listed in the annex
has implemented and maintains a **Quality Management System**.

Scope:
The design and development, manufacture and distribution of products, services and equipment for the Healthcare, Industrial Lifescience Institutional and Speciality Water Treatment and Process Chemical Markets.

Through an audit, documented in a report, it was verified that the management system fulfills the requirements of the following standard.

ISO 9001 : 2015

Certificate registration no.	002201 QM15
Certificate unique ID	170695256
Effective date	2018-09-12
Expiry date	2021-09-11
Frankfurt am Main	2018-09-12

DAkkS
Deutsche Akkreditierungsstelle
D-ZM-16021-02-00

DQS Medizinprodukte GmbH

Sigrid Uhlemann
Managing Director

August-Schanz-Straße 21, 60433 Frankfurt am Main
Tel. +49 (0) 69 9[illegible]

Page 1 / 3

Annex to certificate
Certificate registration No.: 002201 QM15
Certificate unique ID: 170695256
Effective date: 2018-09-12

Ecolab Deutschland GmbH

Ecolab-Allee 1
40789 Monheim am Rhein
Germany

Ecolab Europe GmbH

Richtistr. 7
8304 Wallisellen
Switzerland

Location

Ecolab Ltd.
Brunel Way
Baglan Energy Park,
SA11 2GA
Neath
United Kingdom

Ecolab Production Belgium BVBA
Havenlaan 4, Ravenshout Bed. 4.210
3980 Tessenderlo
Belgium

Ecolab Production France SAS
BP 509, Avenue du Général Patton
51006 Chalons-en-Champagne
France

Ecolab Production Netherlands B.V.
Brugwal 11
3432 NZ Nieuwegein
Netherlands

Ecolab Production Italy S.r.l.
Via Grandi 9/11
20089 Rozzano (MI)
Italy

Ecolab d.o.o.
Vajngerlova 4
2000 Maribor
Slovenia

Ecolab S.A.
25th km., Old National Road Athens Thiva
19600 Mandra Attikis
Greece

Ecolab Ltd.
Forest Park, Zone C
Mullingar Industrial Estate
Mullingar, Co.
Westmeath
Ireland

Ecolab Ltd.
Lotherton Way, Garforth
Leeds
LS25 2JY
United Kingdom

Ecolab Engineering GmbH
Raiffeisenstr. 7
83313 Siegsdorf
Germany

Ecolab Production Belgium BVBA - Equipment Center
Essenschot 6031, Industriezone
Ravenshout 6
3980 Tessenderlo
Belgium

Nalco Deutschland Manufacturing GmbH und Co. KG
Justus-von-Liebig-Str. 11
64584 Biebesheim
Germany

This annex is only valid in connection with the above-mentioned certificate.

Annex to certificate
Certificate registration No.: 002201 QM15
Certificate unique ID: 170695256
Effective date: 2018-09-12

Ecolab Deutschland GmbH

Ecolab-Allee 1
40789 Monheim am Rhein
Germany

Ecolab Europe GmbH

Richtistr. 7
8304 Wallisellen
Switzerland

Location

Ecolab Services Poland Sp. z o.o.
Opolska St 100
31-323 Krakow
Poland

NLC Weavergate
Winnington Avenue
Northwich
Cheshire
CW84DX
United Kingdom

Nalco Warehouse Den Bosch
Europalaan 9
Noord-Brabant
5232 BC Den Bosch
Netherlands

Nalco Nichelino Production
Via Vernea 99
10042 Nichelino (Torino)
Italy

Nalco R&D Leiden
Ir. G. Tjalmaweg 1
2342 BV Oegstgeest
Netherlands

Nalco Italiana Manufacturing srl
Via Ninfina II snc
04012 Cisterna di Latina (LT)
Italy

Budapest Global Business Service Center
Vaci Ut 81-83,
Center Point 2
1139 Budapest
Hungary

Nalco Española Manufacturing SLU
Carrer Tramuntana, s/n
Poligono Industrial de Ceira,
17460 Celrá
Spain

Nalco Finland Manufacturing Oy
Kivikumrnuntie 1
07955 Tesjoki
Finland

3. Neni 60 dhe neni 7 i LPP - Kriteret për Dhënien e Kontratës dhe Trajtimi i barabarte

Sipas nenit 60 të Ligjit për Prokurimin Publik, thuhet qartë se:

"Autoriteti kontraktues do t'ia japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:
1.1. **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**;
Ose
1.2. tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshës që janë specifikuar në dosjen e tenderit, sipas paragrafit 3 të nenit 52 të këtij ligji."

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues **ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore**, duke shpërblyer me kontratë një operator ekonomik i cili **nuk i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit**.

Ky veprim paraqet:

- **Shkelje të parimit të përgjegjshmërisë së ofertës**, pasi që kontrata nuk mund t'i jepet një OE-je i cili nuk i përmbush kriteret thelbësore teknike dhe administrative;
- **Shkelje të barazisë në trajtim** të operatorëve ekonomikë, duke dëmtuar konkurrencën dhe integritetin e procesit të prokurimit;
- **Vendim të pabazuar**, pasi shpërblimi është bërë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit.

Konkretisht Kerkesa ne DT ka qene:

5.6. Traktor me lopatë për pastrimin (largimin) e borës, me kapacitet prej **1100 deri në 1200 cm³ – 2 copë**

OE i rekomanduar ka paraqitur një marrëveshje për traktoret, të cilat kërkohen nga AK, ku janë parashikuar 2 traktorë me lopatë. Sipas marrëveshjes së paraqitur nga OE, njëri prej traktorëve (pika 1) nuk është traktor me lopatë, por vetëm traktor me kabinë, dhe si i tillë nuk përmbush kërkesat e specifikuara në kërkesën e AK-së.

Gjithashtu, në (pikën 2) të marrëveshjes, traktori eshtë jashtë standardeve të kërkuara në FDT, pasi barte një peshë matëse prej 2826 cm³, e cila është dy herë e gjysmë më e lartë se pesha e lejuar sipas kërkesës së AK-së dhe dosjes së tenderit. Pesha e lejuar, sipas kërkesës suaj, duhet të jetë ndërmjet 1100-1200 cm³.

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues (AK):

Sa i përket kapacitetit motorik, edhe pse njëra nga pajisjet e ofruara tejkalon vlerën orientuese të përmendur në FTD, AK thekson se dosja e tenderit **nuk e ka përcaktuar këtë parametër si kriter eliminues apo kufizues**, por vetëm si një tregues orientues që pasqyron nevojën funksionale të Autoritetit Kontraktues. Në këtë kontekst, sipas AK-së, OE i rekomanduar ka ofruar pajisje me kapacitet (vëllim) motorik më të lartë, e cila – sipas tyre – nuk devijon nga qëllimi funksional i pajisjes, përkundrazi, përmirëson performancën dhe efikasitetin në operim, duke garantuar përmbushjen më të mirë të kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

AK pohon se ky vlerësim është në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, konkretisht

me **nenin 59, paragrafi 2**, i cili përcakton: "Autoriteti kontraktues do të vlerësojë dhe krahasojë ofertat vetëm në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Argumenti YNE

Pavarësisht përpjekjes së AK-së për ta paraqitur kapacitetin motorik si "parametër orientues", vetë fakti që në **dosjen e tenderit është specifikuar qartë kërkesa për kapacitet motorik prej 1100 – 1200 cm³**, e bën atë një **kërkesë teknike të detyrueshme**.

OE i rekomanduar ka ofruar pajisje me kapacitet motorik **2826 cm³**, që është **jashtë kufirit të lejuar dhe përbën devijim të qartë nga specifikimet teknike**.

Për më tepër, vetë AK pranon se pajisja tejkalon parametrin e kërkuar, por përpiqet të justifikojë këtë devijim me interpretim të lirë të termit "orientues".

Megjithatë, sipas **nenit 60 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues **nuk mund të shpërblejë me kontratë një OE i cili nuk i përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit**, qoftë edhe një kriter teknik.

Prandaj, vlerësimi i AK-së është në **kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 59 tdhe 60 të LPP-së**, dhe për pasojë, **shpërblimi i këtij OE-je përbën shkelje ligjore.** Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik i cili nuk ka plotësuar kërkesat e përcaktuara për aftësinë teknike dhe profesionale, të parashtruara në dosjen e tenderit. Në rastin konkret, **Autoriteti Kontraktues (AK)** ka shkelur GJITHASHTU parimin e **barazisë dhe mosdiskriminimit** në përputhje me **nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)**, pasi ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik (OE) që nuk e plotësonte kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Arsyetimi i AK-së, i cili i referohet nenit 7 të LPP-së, që ka të bëjë me barazinë dhe mosdiskriminimin, është si më poshtë:

"Të gjithë operatorët ekonomikë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Nuk është identifikuar asnjë favorizim apo avantazh për OE-në e rekomanduar. Vlerësimi është bërë mbi dokumentacionin e dorëzuar në afat dhe përputhshmërinë me kërkesat e FDT-së." Megjithatë, edhe pse AK ka arsyetuar se është bërë një trajtim i barabartë dhe pa diskriminim, **ky argument nuk qëndron** për faktin se një nga operatorët ekonomikë i shpërblyer me kontratë ka ofruar pajisje që **nuk përmbushin kriteret teknike të përcaktuara qartë në dosjen e tenderit**.

Specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme dhe të saktësuara në dokumentet e tenderit, janë shkelur nga OE i shpërblyer, duke ofruar pajisje që **kalojnë kufijtë e përcaktuar për kapacitetin motorik**. Ky është një devijim i drejtpërdrejtë nga kërkesat e dosjes së tenderit, dhe si rezultat, shpërblimi me kontratë i këtij OE-je **përbën shkelje të parimit të barazisë dhe të trajtimit të barabartë të ofertuesve**.

Në përputhje me nenin 7 të LPP-së, **AK ka shkelur parimin e trajtimit të barabartë**, pasi ka shpërblyer një OE që nuk ka përmbushur kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit. Ky veprim është në kundërshtim me parimet thelbësore të **barazisë dhe mosdiskriminimit**, që janë të garantuara në ligjin për prokurimin public.

4. Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve par.10

Neni 108/A i ligjit te prokurimit publik percakton:

10. Autoriteti kontraktues mund, me anë të një vendimi:

10.1. të refuzojë kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabaza;

10.2. të miratojë një kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar;

Bazuar në këtë dispozitë ligjore, Autoriteti Kontraktues ka vetëm dy mundësi kur pranon një kërkesë për rishqyrtim:

- ta refuzojë atë si të pabazuar; ose
- ta pranojë si të bazuar dhe të anulojë në tërësi ose pjesërisht vendimin e mëparshëm.

Në rastin konkret, në kërkesën tonë për rishqyrtim janë evidentuar parregullsi dhe mangësi të rëndësishme në vlerësimin e ofertave, të cilat janë pasqyruar qartë në pretendimet tona. Në përputhje me këto pretendime dhe me parimin e trajtimit të drejtë e të barabartë të operatorëve ekonomikë, Autoriteti Kontraktues është dashur ta kthente çështjen në **rivlerësim**, duke shqyrtuar në mënyrë të pavarur dhe objektive të gjitha ofertat dhe dokumentacionin përkatës.

Megjithatë, në kundërshtim të plotë me kompetencat e përcaktuara në nenin 108/A, Autoriteti Kontraktues ka komunikuar me operatorin ekonomik të shpallur fitues dhe i ka kërkuar atij të deklarohet lidhur me pretendimet tona. Një veprim i tillë nuk është i paparë nga ligji dhe përbën tejkalim të kompetencave të Autoritetit Kontraktues në fazën e trajtimit të kërkesës për rishqyrtim.

Kjo mënyrë veprimi:

- Cënon rëndë parimin e barazisë dhe trajtimit të paanshëm të operatorëve ekonomikë;
- Është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së;
- Dëmton integritetin dhe besueshmërinë e procesit të prokurimit publik.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka **shkelur nenin 108/A, paragrafi 10** të Ligjit për Prokurimin Publik, duke vepruar jashtë kompetencave të përcaktuara me ligj dhe duke mos trajtuar në mënyrë të drejtë dhe ligjore kërkesën tonë për rishqyrtim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Bazuar në pretendimet tona të elaburuara më lartë kërkojm nga OSHP që pretendimet tona dhe kërkesën tonë ta trajtoj në hollësi dhe nga kjo të miratoj:

Vendim

- **Arovohet si e bazuar** kërkesa e operatorit ekonomik Schafberger-Jr.GmbH-Dega Kosovë në lidhje me aktivitetin me titull Sherbime mbeshtetëse në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës Loto 1 Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike numër të prokurimit 101-25-353-2-1-1 dhe numër të bredëshëm KU101 25 001 211

- **Anulohet njoftimi mbi vendimin** e Autoritetit Kontraktues Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe lënda të kthehet në rivlerësim dhe pas rivlerësimit të shpallemi fitues të këtij aktiviteti të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke shperblyer me kontrate OE i cili eshte i papergjegjshem, gjë që ka shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta materiale, përfshirë:

- Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionit mbështetës;
- Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundshme;
- Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. *një kopje e Njoftimit mbi kontrate*
2. *një kopje e Njoftimit mbi Vendimin e AK*
3. *nje kopje e Kerkeses per rishqyrtim*
4. *një kopje te vendimit te AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
5. *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
6. *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*
7. ***Komunuikimi me ATK***

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

From: Standardet Profesionale <Standardet.Profesionale@atk-ks.org>
Date: Tue, May 13, 2025 at 1:36 PM
Subject: Njoftim lidhur me kerkesen tuaj te datës 05.05.2025
To: schafberger <schafbergerkosove@gmail.com>
Cc: Info <info@atk-ks.org>, Xhemail Halili <Xhemail.Halili@assembly-kosova.org>, Valmira Deliu.Bucaj <Valmira.Deliu.Bucaj@assembly-kosova.org>, Standardet Profesionale <Standardet.Profesionale@atk-ks.org>

I/e nderuar,

Kemi trajtuar informacionin tuaj dhe ju njoftojmë se rasti është adresuar në Departamentin e Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës.

Sipas nenit 66 paragrafi 2, pikat 2.7 dhe 2.14 te ligjit .08/L-257 Për Administrimin e Procedurave Tatimore të dhënat në detaje për ketë rast mund t'i ofrohen me kërkesën e tyre vetëm zyrtareve shtetërorë për kryerjen e detyrave zyrtare.

Me respekt

Div. Standardet Profesionale
Prishtinë - Drejtoria e Përgjithshme
cid:image001.png@01DA1EC8.03AA0EE0
Tel: +383 38 200 250 46
Fax: +383 38 200 250 07
Ueb: www.atk-ks.org

From: schafberger <schafbergerkosove@gmail.com>
Sent: Monday, May 5, 2025 10:08 AM
To: Info <info@atk-ks.org>; Xhemail Halili <Xhemail.Halili@assembly-kosova.org>; Valmira Deliu.Bucaj <Valmira.Deliu.Bucaj@assembly-kosova.org>
Subject: Kërkes

Të nderuar,

Ne, si kompani e pastrimit, jemi në proces të tenderimit pranë autoritetit kontraktues – Kuvendi i Republikës së Kosovës. Gjatë vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktues ka publikuar njoftimin për dhënien e kontratës një kompanie tjetër, për të cilën kemi kërkuar qasje në dokumentacionin përkatës.

Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të kësaj kompanie, kemi hasur në dyshime të bazuara se një faturë e lëshuar me datën 05.11.2024, me numër 189/2024, mund të jetë e padeklaruar dhe e dyshuar si (fiktive). Për këtë arsye, kërkojmë nga ju që të bëni verifikimin e nevojshëm, pasi që me ekzistencën e këtyre faturave të parregullta:

Ne, si kompani konkurrente, po eliminohemi padrejtësisht nga gara për shkak të keqpërdorimeve që po na shkaktohen nga kompani të pandërgjegjshme.
Faturën për të cilën kemi dyshime mirë të bazuara se nuk është deklaruar në ATK do ta bashkëngjisim me këtë shkresë.

Ju lusim të merrni masa në përputhje me ligjin dhe të na informoni, në një afat sa më të shpejtë të mundshëm, lidhur me hapat e mëtejshëm.

Te bashkangjitur gjeni ne atach faturen;

Me respekt

Schafberger